



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:045437
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05269428

C.nr.1421/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. Sh., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N. H., avokat nga Prishtina, me adresë në rr. "G..", hyrja, numër ..., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 31.01.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. Sh., nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditëses:

- Në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75% të një page bazë t'ia kompensoj shumën prej 303.75 € (treqind e tre euro e shtatëdhjetë e pesë cent); dhe
- Në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për 946 ditë të punës për periudhën nga data 17.04.2017 e deri më datë 21.11.2022, t'ia paguaj shumën prej 1,892.00 € (njëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy euro), apo shumën e përgjithshme prej 2,195.75 €, (dymijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses A. Sh., përtej shumës së përgjithshme të aprovuar si në pikën -I- të këtij dispozitivi, dhe atë në shumën prej 90.00 € (nëntëdhjetë euro), si e pa bazuar.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 134.00 € (njëqind e tridhjetë e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 22.04.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, me bazë juridike kompensim i pagës jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë. Të njëjtën e ka precizuar sipas parashtrësës së datës 17.11.2023.

Në padi dhe precizim, ndër të tjera theksohet se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e punësuar në institucionin arsimor SH.F.M.U. “H. P.,” e sistemuar në vendin e punës *mësuese klasore*, sipas kontratës së punës me numër të protokollit 438/I, të datës 12.02.2000, me përvojë pune në institucione shkollore për më shumë se 22 vite. Tutje, në padi theksohet se me rastin e plotësimit të kushtit për shpërblim jubilar, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, nënshkruar më datë 18.04.2017, paditëses i takon e drejta e kompensimit prej 75 % të një page bazë – jubilarë për 22 vite përvojë pune si dhe kompensimi për ushqim gjatë punës, të cilat të drejta i përcakton neni 35 paragrafi 7 dhe paragrafi 8 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu, në padi theksohet se meqenëse paditëses nuk i është rimbursuar paga jubilarë deri më tani, e njëjta më datë 27.03.2020, i është drejtuar organit kompetent përgjegjës të të paditurës me kërkesë për kompensimin e pagave të cilat ligjërisht i takojnë. Lidhur me këtë kërkesë, theksohet se nga e paditura nuk ka pranuar asnjë lloj përgjigje. Në kuptim të të lartcekurave ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadija si e bazuar dhe të obligohet e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Arsim që në emër të shpërblimit jubilar për 26 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë ta kompensoj shumën prej 303.75€, dhe në emër të kompensimit për ushqim, për periudhat 2017 – 2022, e gjithsej 946 ditë pune, t’ia kompensoj shumën në lartësi prej 1,892.00€, e në shumë të përgjithshme prej 2,285.75 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon nga data e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datë 30.11.2023, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Tutje, ka shtuar se kompensime të tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, si rezultat i fakteve të lartpërmendura e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saja buxhetore linjë të veçantë buxhetore, për këto lloje të kompensimeve. Mbi bazën e këtyre pretendimeve i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor.

Me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: “LPK”), përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*. Neni 398 i LPK-së, përcakton se: *“Kur gjykata,*

pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” Ndërsa, neni 399 LPK-së, përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësja A. Sh., ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, pranë institucionit arsimor SH.F.M.U. “H. P.,” në Prishtinë, e sistemuar në titullin e punës mësimdhënëse e mësimi klasor. Ky fakt vërtetohet me Kontratën e punës me numër protokoli 438/I, të datës 12.02.2000. Nga kjo kontratë, po ashtu është vërtetuar se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 405.00 €. Sipas vërtetimit Nr.417/VI, të datës 14.11.2023, lëshuar nga institucioni ku është e punësuar paditësja, është vërtetuar se e njëjta është sistemuar në punën dhe detyrat e punës mësimdhënëse e mësimi klasor nga data 12.02.2000 e deri më kohë të pacaktuar dhe se e njëjta ka 26 (njëzet e gjashtë) vite përvojë pune në arsim. Ndërsa, nga vërtetimi me numër protokoli 416/VI, të datës 14.11.2023, është vërtetuar fakti se paditësja përgjatë periudhës kohore nga data 17.04.2017 e deri më datë 21.11.2022, ka realizuar gjithsej 946 ditë të pranisë në punë.

Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e tri Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkuara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 11.04.2014, 18.04.2017, respektivisht me datë 22.01.2021.

Referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, e në lidhshmëri me provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, në mënyrë specifike nga vërtetimi me numër protokoli Nr.417/VI, i datës 14.11.2023, i lëshuar nga SH.F.M.U. “H. P.,” në Prishtinë, vërtetohet se paditësja vitin jubilar të punësimit për 20 vite të përvojës së punës e ka arritur më datë 12.02.2020. Andaj, duke qenë se paditëses i ka lindur e drejta e kompensimit të shpërblimit jubilar, pikërisht në muajin shkurt të vitit 2020, kjo Gjykatë vlerëson se kërkesëpadia e paditëses lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017.

Ndërkaq, përkitazi me pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, Gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e ushqimit për datën 17.04.2017 gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, të nënshkuar më datë 11.04.2014, e cila ka qenë e zbatueshme nga data 01.01.2015 deri me datë 17.04.2017. Kërkesëpadia e paditëses lidhur me

kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore nga data 18.04.2017, e deri më datën 21.01.2021, gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022, gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, në mënyrë identike parashihet me dispozitën nga neni 35 par.7 të Kontratave të lartcekura, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Ndërkaq, çështja e kompensimit të shpërblimit jubilar, parashihet me dispozitën nga neni 35 par.8 të Kontratave të lartcekura, ku është përcaktuar se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50% të një page bazë; 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; 8.3.për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”*.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar. Mbi këtë bazë, lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve për ushqim, është bërë përlllogaritja në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2 euro për ditë pune, e bazuar në faktin se nga provat e administruara u vërtetua se paditësja për periudhën kohore të specifikuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka gjithsej 946 ditë të prezencës në punë, të njëjtës i takon kompensimi në shumën e përgjithshme prej 1,892.00 €.

Ndërsa, lidhur me kompensimin në emër të shpërblimit jubilar, përlllogaritja është bërë duke u bazuar në pagën bazë të cilën e realizon e paditura. Kështu, nga provat e bashkëngjitura u vërtetua se e njëjta realizon pagë bazë në vlerë prej 405.00 €, dhe se me një përlllogaritje të thjeshtë, duke e nxjerrë vlerën e 75 % nga shuma prej 405.00 € (paga bazë e paditëses), rezulton se paditëses,

në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar i takon shuma prej 303.75 €. Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në dy rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, si dhe lidhur me faktin se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: *“Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”*. Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e kësaj Kontrate, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lart cekur, në njërën anë janë paraparë të drejta për njërën palë, e në anën tjetër janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësja t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadsisë, Gjykata gjeti se shuma prej 90.00 €, nuk gjenë mbështetje në ndonjë bazë juridike mbi të cilën do të mund t'i njëhej si kompensim këtu palës paditëse. Për më tepër, konstatohet se nga kërkesa për kompensimin e pagës jubilarë në vlerë prej 303.75 €, dhe kërkesa për kompensimin e shujtave ditore në vlerë prej 1,862.00, nëse mblidhen, del të jetë shuma e përgjithshme prej 2,195.75 € ($1,862.00 + 303.75 = 2,195.75$), e jo shuma prej 2,285.75 si shumë e përgjithshme e precizuar me parashtrësën e datës 17.11.2023, andaj edhe është vendosur si në pikën - II - të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, të ia paguajë së bashku me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila kamatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padsisë në Gjykatës, e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore nga pika III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 453, 452 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditëses t'ia kompensojë shumën e tërësishme të

shpenzimeve të nevojshme deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 134.00 euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104.00 euro dhe 30.00 euro në emër të taksës për padi. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, pasi që e njëjta vlerësoi se nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja, gjegjësisht padia fillestare, ka pasur të meta.

Bazuar në të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1421/2020, më datë 31.01.2024

Gjyqtarja
Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët.